

AKTI I THEMELIMIT
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TE KUFIZUAR
AMERICAN ALBANIAN UNIVERSITY SH.P.K

Neni 1

Emri

Emri i shoqërisë është **American Albanian University Shpk.**, me poshte referuar si shoqëria.

Neni 2

Themelimi

Shoqëria fiton personalitet juridik pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit

Neni 3

Selia

Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën Rr. Komuna Parisit, Pll. Alban Tirana, kt. 7, Tirane, Shqiperi. Shoqëria mund te hape dege dhe/ose te krijojë filiale, si dhe te kryejë aktivitetin e saj si brenda, ashtu edhe jashtë territorit te Shqipërisë sipas vendimit te Asamblese se Ortakeve te Shoqërise.

Neni 4

Kapitali Themeltar


Kapitali themeltar është 100.000 (njëqind mije) Lek dhe është i ndare ne 100 kuota me vlere nominale 1000 Lek secila. Kapitali themeltar është nënshkruar dhe derdhur tërësisht nga ortaket e shoqërise:

1. Z. Michael Elbert Ussery, Shtetas amerikan, lindur ne South Carolina USA me date 20/01/1951, adresa 345 Hidden Creek LN, Warrington VA 20186, USA, mbajtes i pasaportes nr. 435659446, zoterues i 50 kuotave qe perfaqesojne 50% te kapitalit themeltar.
2. Znj. Majlinda Myrto, nenshtetase Amerikane, lindur ne Durrës me 20/05/1966, Adresa: 331 Latham Road, Mineola NY 11501, USA, mbajttese e pasaportes No: 476077311, zoteruese e 50 kuotave qe perfaqesojne 50% te kapitalit themeltar. which represent 50% of the share capital.

Kuotat e kapitalit janë lirisht te transferueshme dhe transferohen ne çdo moment sipas ligjit ne fuqi.

Ortakët do te kene te drejten e parablerjes ne rast te transferimit te kuotave.

Pergjegjesia ortakeve shtrihet deri ne kontributin e tyre ne kapitalin themeltar.

Majlinda Myrto


Neni 5

Objekti

Objekti i Shoqërisë është të kryejë cdo lloj transaksioni dhe aktiviteti të ligjshëm si dhe të hyjë në cdo lloj marrëveshje të ligjshme që i lejohet aktualisht një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në Republikën e Shqipërisë, apo që mund të ndryshojnë me vone, në fushën e:

- Edukimit privat dhe publik. Organizimin e të gjithë aktivitetëve të lidhura me procesin e edukimit dhe aktivitetëve inovative.
- Prodhim, import-eksport dhe tregtim i mallrave, librave, laboratorëve dhe cdo lloj materiali arsimor që lidhet me qëllimin e aktivitetit.
- aktivitetin e ndërtimit dhe atë që ka lidhje me pasuritë e paluajtëshme, si për llogari të vet ashtu edhe për llogari të enteve publike dhe private, si edhe ndërtimin, restaurimin, riparimin, shkëmbimin, blerjen, shitjen, dhënie me qira, menaxhimin, administrimin e pasurive të paluajtëshme të veta ose të të tretëve, tregtare ashtu edhe industriale, edhe të mobiluara, lidhja e kontratave të sipërmarrjes si dhe zhvillimi i të gjitha aktivitetëve të lidhura direkt ose indirekt me aktivitetin e ndërtimit dhe atë që ka lidhje me pasuritë e paluajtëshme në përgjithësi përfshirë aktivitetin e ndërmjetësimit në lidhje me pasuritë e paluajtëshme;
- aktivitetin e ndërtimit, drejtimit dhe dhënie me qira të strukturave akomoduese dhe hoteliere (hotele, pensione, fshate turistike) të strukturave akomoduese, ekstra hoteliere (kampingje, bungalou, qendra akomodimi) të ndërmarrjeve me restaurimet;
- realizimin dhe aktivitetin e drejtimit të impianteve, aparaturave dhe teknologjive të ndryshme në fushën e industrisë.
- cdo aktivitet tejter të lejuar nga ligjet shqiptare në fuqi;

Neni 6

Afati

Afati i veprimtarisë së shoqërisë është i pakufizuar.

Neni 7

Administrimi

1. Funksioni dhe Autoriteti

Administrimi i Shoqërisë do të kryhet nga Administratori i vetëm i cili kryen të gjitha veprimet në lidhje me aktivitetin e zakonshëm dhe ushtron të gjitha të drejtat e menaxhimit të shoqërisë me përjashtim të kompetencave që ligji apo akti i themelimit ua jep shprehimisht ortakeve.



Cdo transaksion ne emer te shoqerise kryhet me miratimin dhe nenshkrimin e Administratorit te Shoqerise.

Administratori mund te delegoje pjeserisht ose gjithte te drejttat e tij personave te trete me ane prokurash noteriale.

2. Emerimi dhe Afati

Administratori i shoqerise emerohet me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve dhe do te mbaje kete detyre deri ne zevendesimin e tij ose deri ne doreheqjen, shkarkimin ose vdekjen.

Administratori i pare i shoqerise i zgjedhur me nje afat 3 vjecar do te jete:

Znj. Majlinda Myrto, nenshtetase Amerikane, lindur ne Durres me 20/05/1966, Adresa: 331 Latham Road, Mineola NY 11501, USA, mbajttese e pasaportes No: 476077311

3. Pergjegjesia

Administratori eshte individualisht pergjegjes ndaj shoqerise dhe personave te trete per deme qe shkaktohen ne shkelje te ligjeve dhe neneve te ketij akti i themelimiti.

Neni 8

Ligji i zbatueshem

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne perputhje me kete akti i themelimit dhe ligjin shqiptar.

Për sa nuk parashikohet nga ky akti i themelimit do te zbatohet legjislacionit ne fuqi ne territorin e Shqipërisë për shoqëritë tregtare.

Gjykata ku ka selinë shoqëria ka kompetence ekskluzive për zgjidhjen e te gjitha mosmarrëveshjeve qe mund te lindin mes ortakeve, mes këtyre dhe organeve te shoqërisë apo shoqërinë, dhe ne çdo rast kur shoqëria do te paditet ne gjykim.

Neni 9


Amendimet

Ky akti i themelimit do te amendohet, rishikohet, ose do te shfuqizohet me ane te nje akti i themelimiti tjeteter, me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 10

Rregjistrimi

Ortaket autorizojne Z. Gedeon Dudushi dhe Z. Poljon Xhoga qe se bashku ose vec e vec te regjistrojne kete shoqeri prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.



Nenshkuar sot me date 09.03.2012.

ORTAKET

MAJLINDA MYRTO

Majlinda Myrto

Michael Ussery

Michael Ussery